



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E KULTURËS  
KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 1408 Prot.

Tiranë, më 11.11 2019

**VENDIM Nr. 239, datë 08.11.2019**

Në mbështetje të *Ligjit Nr. 27/2018 "Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë"* Neni 145, Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr. 13, datë 08.11.2019, pasi shqyrtoi Raportin e gërmimit arkeologjik të shpëtimit në kuadër të projektit *"Godinë banimi dhe shërbime 5 kate", rruga "Anastas Durrsaku", në zonën arkeologjike "B" Durrës-* subjekti "JEDAS" sh.p.k, realizuar nga individ i licencuar Z. Skënder Muçaj,

**VENDOSI:**

1. Të miratojë Raportin e gërmimit arkeologjik të shpëtimit në kuadër të projektit *"Godinë banimi dhe shërbime 5 kate", rruga "Anastas Durrsaku", në zonën arkeologjike "B" Durrës-* subjekti "JEDAS" sh.p.k. realizuar nga individ i licencuar Z. Skënder Muçaj.
2. Materiali arkeologjik dhe të gjitha skelet të depozitohen pranë fondeve të Muzeut Arkeologjik Durrës.
3. Për varret e zbuluara nga gërmimi arkeologjik i shpëtimit, Investitori të kontrakttojë një subjekt të licencuar në restaurim, i cili të hartojë një projekt konsolidimi dhe konservimi dhe të paraqitet në KKA e rradhës, duke rishikuar gjurmën e projektit.
4. Të bëhet dokumentimi i saktë i varreve, studimi i materialit arkeologjik dhe të botohet raporti i plotë i gërmimit të shpëtimit.
5. Procesi i zhvendosjes dhe depozitimi i skeleteve dhe materialit arkeologjik pranë Muzeut Arkeologjik Durrës, do të realizohet nën monitorimin e DRKK Durrës.
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
7. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.



SEKRETAR I KKA  
RUDINA ZOTO